

YERVOY®

(ipilimumab)

Karta e Pacientit

Kjo Kartë e Pacientit përmbush kushtet e autorizimit për marketing dhe ka qenë miratuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Informacion i RËNDËSISHËM për Pacientët

Mbani këtë kartë gjithmonë me vete për të informuar profesionistët e kujdesit shëndetësor se po trajtoheni vetëm me YERVOY®.



Nëse keni ndonjë shenjë ose simptomë, informoni mjekun tuaj menjëherë.

EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME



Zorrë dhe
stomak

Diarre (jashtëqitje me ujë, të lirshme ose të buta), jashtëqitje të përgjakshme ose me ngjyrë të errët, jashtëqitje më të shpeshta se zakonisht, dhimbje ose ndjeshmëri në stomak ose në zonën e barkut, të përziera ose të vjella



Sy

Skuqje në sy, dhimbje në sy, probleme me shikimin ose shikim të paqartë



Gjëndrat
hormonale

Rrahje të shpejta të zemrës, djersitje e shtuar, shtim ose humbje në peshë, ndjesi të ftohti, rënie flokësh, kapsllëk, zëri juaj bëhet më i thellë, ethe, lodhje, dhimbje koke, marramendje ose të fikët, ndjenjë më e madhe e urisë ose e etjes se zakonisht, nevojë për të urinuar më shpesh, ose ndryshime në sjellje (p.sh., ulje e dëshirës seksuale, të qenit i irritueshëm ose harresë)



Mëlçia

Zverdhje e syve ose e lëkurës (verdhëz), dhimbje në anën e djathtë të zonës së stomakut, urinë e errët, ose gjakderdhje



Mushkëritë

Vështirësi në frymëmarrje, kollë ose dhimbje në gjoks



Nervat

Dobësi e muskujve, mpirje ose ndjesi shpimi gjilpërash në këmbë, krahë ose fytyrë, marramendje, humbje e vetëdijes ose vështirësi në zgjim



Lëkura

Skuqje e lëkurës me ose pa kruajtje, lëkurë e thatë, flluska dhe/ose qerim i lëkurës, plagë në gojë, ënjtje të fytyrës ose gjëndrave limfatike

Efekte tjera anësore të rëndësishme:

Reaksionet e rënda të infuzionit:

- Reaksionet ndaj injektimit të ipilimumab në qarkullimin e gjakut mund të ndodhin, zakonisht gjatë ose brenda 24 orëve nga marrja e një doze.
- Njoftoni menjëherë mjekun ose infermierin tuaj nëse keni këto simptoma gjatë një infuzioni të ipilimumab: ethe ose dridhje, kruajtje ose rash, skuqje, vështirësi në frymëmarrje, marramendje, ethe dhe ndjesi sikur po të bie të fikët.

E RËNDËSISHME

- Tregoni mjekut tuaj për çdo gjendje mjekësore të mëparshme.
- Trajtimi i hershëm i efekteve anësore zvogëlon gjasat që trajtimi me ipilimumab do të duhet të ndërpritet përkohësisht ose përgjithmonë.
- Shenjat dhe simptomat që mund të duken të lehta mund të përkeqësohen shpejt nëse nuk trajtohen.
- MOS u përpikuni t'i trajtoni vetë këto simptoma.

- Shenjat dhe simptomat mund të vonohen dhe mund të shfaqen javë deri në muaj pas injeksionit tuaj të fundit të ipilimumab.

Për më shumë informacion, lexoni fletëudhëzuesin e paketimit të ipilimumab ose kontaktoni:
me e-mail, në e-mail adresën:
medinfo.kosovo@swixxbiopharma.com

Informacion i RËNDËSISHËM për Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor

- Ky pacient trajtohet me ipilimumab monoterapi
- Reaksionet anësore të lidhura me imunitetin (irARs) mund të shfaqen në çdo kohë gjatë trajtimit ose muaj pas ndërprerjes së terapisë.
- Diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi i duhur janë thelbësore për të minimizuar komplikimet kërcënuese për jetën.
- Konsultimi me një onkolog ose specialist tjetër mjekësor mund të jetë i dobishëm për menaxhimin e irAR-ve specifike për organet.
- Profesionistët shëndetësor duhet t'i referohen Përmbledhjes së Karakteristikave të Produktit (SmPC) të ipilimumab ose kontaktoni me e-mail, në e-mail adresën:
medinfo.kosovo@swixxbiopharma.com

Profesionisti shëndetësor që trajton këtë pacient me ipilimumab duhet të plotësojë seksionin "Informatat kontaktuese të Mjekut tim" të kësaj Karte paralajmëruese për pacientin

Informatat kontaktuese të Mjekut tim (i cili ka përshkruar ipilimumab)

Emri i mjekut: _____
Telefoni i zyrës: _____
Telefoni pas orarit të punës _____

Informacioni im i kontaktit

Emri im dhe telefoni: _____
Emri dhe telefoni i kujdestarit (në rast urgjence):

